



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E SHENDETESISE
QENDRA KOMBETARE E EDUKIMIT NE VAZHDIM

Disa ndryshime në Kuadrin Regullator të RICERTIFIKIMIT të Profesionistëve të Shëndetësisë

1. Në kapitullin III – *Aktivitetet e Edukimit në Vazhdim dhe Kreditet Përkatëse*, pika 1, pas paragrafit të fundit të shtohet : “ Për çdo temë të referuar në aktivitet, referues/lektorë do të konsiderohen vetëm dy autorët e parë.

Profesionistët që janë organizatorë të aktivitetit përfitojnë kredite që përlogariten në bazë të kriterit 1 orë – 2 kredite. Për cdo aktivitet, organizatorë do të konsiderohen jo më shume se dy profesionistë.

2. Në kapitullin III – *Aktivitetet e Edukimit në Vazhdim dhe Kreditet Përkatëse*, pika 2a, “*Kërkimet/botimet*” pas paragrafit të fundit shtohet : “ Një abstrakt ose poster i botuar në librin përmbledhës të abstrakteve të një aktiviteti të edukimit në vazhdim (konferencë, kongres etj.) të zhvilluar jashtë vendit, në rastin kur profesionisti nuk është pjesëmarrës në aktivitet, vlerësohet si botim artikulli në reviste nderkombetare shkencore mjekesore. Numri i krediteve të përfituara është deri 20 kredite, në varësi të numrit të autorëve.

Limiti: Pavarësisht nga numri i abstrakteve të botuara brenda të njëjtit aktivitet, vlerësimi bëhet vetëm për një të tillë.

Abstrakti ose poster i botuar në librin përmbledhës të abstrakteve të një aktiviteti të edukimit në vazhdim të zhvilluar brenda vendit, në rastin kur profesionisti nuk është

pjesëmarrës në aktivitet, vlerësohet si botim në një revistë kombëtare mjekësore shkencore. Numri i krediteve të përfituara është 15 kredite, në varësi të numrit të autorëve.

Limiti: Pavarësisht nga numri i abstrakteve të botuara brenda të njëjtit aktivitet , vlerësimi bëhet vetëm për një të tillë.”

3. Në kapitullin III – *Aktivitetet e Edukimit në Vazhdim dhe Kreditet Përkatëse*, pika 2b, “*Aktivitetet e vetëraportuara*” pas paragrafit të fundit shtohet: “Pjesëmarrja në një në një vizitë studimore të strukturuar, brenda ose jashtë vendit (observership, study tour etj.) në një institucion shëndetësor publik ose privat, vlerësohet me 0.5 kredite në ditë (30 min)¹”

4. Në kapitullin III – *Aktivitetet e Edukimit në Vazhdim dhe Kreditet Përkatëse*, shtohet pika 3: “**Programe universitare të akredituara**”. Kjo kategori aktivitetesh përfshin kurset e akredituara pasuniversitare me afat të shkurtër, programet e nivelit Master dhe programet e doktoraturës , brenda ose jashtë vendit. Konvertimi i krediteve universitare në kredite të edukimit në vazhdim bëhet në bazë të kriterit 1 kredit universitar = 25 kredite të edukimit në vazhdim.”

¹ Merret në konsideratë fakti që profesionisti në çdo ditë pune gjatë vizitës studimore përfiton rreth 30 minuta në ditë njohuri profesionale shkencore gjatë konsultave dhe diskutimeve të rasteve me kolegët.